



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

PROGRAM

**PËR EDUKIM TË DETYRUESHËM TË KOMISIONEVE
KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE, TË KOMISIONIT
ZGJEDHOR TË QYTETIT TË SHKUPIT DHE
KËSHILLAVE ZGJEDHORË**

ZGJEDHJET LOKALE 2021

Përgatitur nga:

Admir Shabani, udhëheqës sektori dhe
Lupka Guguçevska Filiposka, udhëheqëse seksioni

1. QËLLIMI I PROGRAMIT

Qëllimi i Programit për edukim të detyrueshëm të komisioneve komunale të zgjedhjeve, të komisionit zgjedhor të Qytetit të Shkupit dhe këshillave zgjedhorë është përcaktimi i:

- formës së edukimit të anëtarëve të organeve zgjedhore,
- numrit të punëtorive për edukim,
- temave që do të jenë lëndë e secilës punëtori,
- kornizës kohore gjatë së cilës do të organizohen punëtoritë (në pajtim me Kalendarin e afateve për realizimin e proceseve zgjedhore).

Nëpërmjet realizimit të këtij Programi do të përmbushen këto qëllime:

1. Do të krijohet bazë e trajnuesve të trajnuar të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve;
2. Do të sigurohet që trajnimi i administratës zgjedhore është realizuar me kohë dhe plotëson standarde të larta;
3. Do të ndiqet shembulli nga praktikat e mira ndërkombëtare dhe i qendrave funksionale për edukim të vazhdueshëm të organeve zgjedhore;
4. Do të instalohet sistem më i rreptë i certifikimit të pjesëmarrësve në trajnimet;
5. Do të monitorohet parimi i trajnimeve kaskadë, trajnime për trajnuesit.

Pas përfundimit të edukimit, të gjithë anëtarët e komisioneve komunale të zgjedhjeve dhe të këshillave zgjedhorë do të jenë në gjendje t'i përmbushim obligimet ligjore në mënyrë cilësore profesionale dhe me kohë.

Për realizimin e këtij Programi për edukim të detyrueshëm të anëtarëve të administratës zgjedhore, do të zbatohen tre nivele të trajnimeve dhe edukimi siç janë:

- 1) Trajnim për trajnues
 - Këto trajnime do t'i zbatojnë udhëheqësit e Sektorit për edukim të vazhdueshëm të organeve zgjedhore dhe të qytetarëve, marrëdhënie me publikun dhe bashkëpunim ndërkombëtar (në tekstin e mëtejme: Sektori për edukim) i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve
- 2) Edukim i anëtarëve të komisioneve komunale të zgjedhjeve dhe komisionit zgjedhor të Qytetit Shkup
 - Këtë edukim e zbaton Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve përkatësisht anëtarë të ekipit për edukim i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- 3) Edukim i anëtarëve të këshillave zgjedhorë
 - Këtë edukim e zbatojnë trajnuesit e certifikuar të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

2. EKIPI PËR ZBATIM TË EDUKIMIT

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, për zbatimin e edukimit të detyrueshëm të organeve zgjedhore do të formojë ekip për edukim.

Ekipi për edukim do të përbëhet prej së paku 120 individë të trajnuar për problematikën zgjedhore, ndërsa do të jetë i formuar nga:

- persona të punësuar në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, dhe
- trajnues të certifikuar të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

2.1. Formimi i ekipit për edukim

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve do të komunikojë me thirrje publike për paraqitje të kandidatëve të interesuar për të qenë pjesë e ekipit për edukim në KSHZ. Do të zgjedhen së paku 45 trajnues nëpërmjet kësaj thirrjeje publike.

Ky aktivitet do të përfundojë deri në fund të muajit gusht 2021.

Kapacitetet e trajnuesve të zgjedhur do të përforcohen nëpërmjet organizimit të punëtorive pesëditore për njoftim me teknikat për trajnimin e të rriturve si dhe për njoftim me procesin zgjedhore dhe kompetencat e organeve zgjedhore dhe me pjesëmarrësit e tjerë në zgjedhjet. Trajnuesit në këto punëtori do të jenë të punësuarit në Sektorin për edukim në Shërbimin profesional të KSHZ-së.

Trajnuesit të cilët me sukses do ta mbarojnë trajnimin do të fitojnë certifikatë për trajnues të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. KSHZ-ja do të lidh kontratë për angazhimin e tyre profesional e cila do t'i përkufizojë të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre. Trajnuesit do të punojnë në terren në ekipe të përziera prej dy deri tre anëtarësh, ndërsa secili ekip do të jetë kompetent për më së shumti tre deri katër komuna.

Plani i detajuar dhe orari do të përcaktohen në bashkëpunim me trajnuesit dhe komisionet komunale të zgjedhjeve.

Për procesin e ardhshëm zgjedhor, secili trajnues do të duhet ta rinovojë certifikatën.

Krahas këtyre 45 trajnuesve, në ekipin për edukim do të përfshihen edhe:

- trajnuesit e certifikuar të KSHZ-së nga ciklet e kaluara zgjedhore dhe
- të punësuarit në Shërbimin profesional të KSHZ-së të cilët do të vizitojnë trajnim për trajnues.

2.2. Përpilim i materialeve për trajnime

Nën mbikëqyrjen e të punësuarve në Sektorin për edukim nga Shërbimi profesional i KSHZ-së, trajnuesit do të marrin pjesë në përpilimin e materialeve për trajnime:

- Doracak për edukim të KKZ-ve dhe KZ-ve si dhe
- Kurrikulë për trajnime, duke përfshirë: udhëzues për trajnuesit, Power Point prezantime, aktivitete, ushtrime për pjesëmarrës dhe ngjashëm.

3. TRAJNIME PËR TRAJNUESIT

3.1. Trajtime për trajnuesit për të punësuarit në shërbimin profesional të KSHZ-së

Trajnues: Të punësuarit në Sektorin për edukim në shërbimin profesional të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Pjesëmarrës: Të punësuarit në shërbimin profesional të KSHZ-së

Orari i punëtorisë: 23 -25 gusht

Do të mbahet një punëtori treditore, me grup prej 12 pjesëmarrësve.

Pjesëmarrësit do t'i rinovojnë njohuritë e tyre për teknikat për trajnimin e të rriturve, shkathtësitë e trajnuesit të mirë, si dhe për procesin zgjedhor, kompetencat e organeve zgjedhore dhe pjesëmarrësit tjerë në zgjedhje. Pjesëmarrësit do t'i mësojnë në detaje edhe doracakët për edukimin e organeve zgjedhore, ndërsa do të krijojnë edhe aktivitete për trajnimin e anëtarëve të komisioneve komunale të zgjedhjeve dhe të komisionit zgjedhor të Qytetit të Shkupit.

Pas mbarimit me sukses të këtyre trajnimeve, pjesëmarrësit do t'i rinovojnë certifikatat për trajnues për zgjedhje në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve.

3.2. Trajtime për kandidatë të ri për trajnues

Trajnues: Të punësuarit në Sektorin për edukim në shërbimin profesional të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Pjesëmarrës: Kandidatë të rekrutuar përmes thirrjes për paraqitje

Orari i punëtorive: 30 gusht – 4 shtator dhe 6 – 11 shtator

Do të mbahen dy punëtori pesëditore, me grupe të përziera (më së shumti 30 pjesëmarrës në grup, duke i përfshirë edhe trajnuesit).

Pjesëmarrësit do të njoftohen me teknikat për trajnimin e të rriturve, shkathtësitë e trajnuesit të mirë si dhe me procesin zgjedhor, kompetencat e organeve zgjedhore dhe me pjesëmarrësit tjerë në zgjedhje. Pjesëmarrësit do t'i mësojnë në detaje edhe doracakët për edukimin e organeve zgjedhore, ndërsa do të krijojnë edhe aktivitete për trajnimin e anëtarëve të komisioneve komunale të zgjedhjeve dhe të komisionit zgjedhor të Qytetit të Shkupi.

Pas mbarimit me sukses të këtyre trajnimeve, pjesëmarrësit do t'i rinovojnë certifikatat për trajnues për zgjedhje në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve.

3.3. Trajtime të avancuara për trajnuesit

Trajnues: Të punësuarit në Sektorin për edukim në shërbimin profesional të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Pjesëmarrës: Trajnuesit e certifikuar të KSHZ-së nga ciklet e kaluara zgjedhore

Orari i punëtorive: 13 -15 dhe 16 – 18 shtator

Do të mbahen dy punëtori treditore, me grupe të përziera (më së shumti 30 pjesëmarrës në grup, duke i përfshirë edhe trajnuesit).

Pjesëmarrësit do t'i rinovojnë njohuritë e tyre për teknikat për trajnimin e të rriturve, shkathtësitë e trajnuesit të mirë, si dhe për procesin zgjedhor dhe kompetencat e organeve zgjedhore dhe pjesëmarrësit tjerë në zgjedhje. Pjesëmarrësit do t'i mësojnë në detaje edhe doracakët për edukimin e organeve zgjedhore, ndërsa do të krijojnë edhe aktivitete për trajnimin e anëtarëve të këshillave zgjedhorë.

Pas mbarimit me sukses të këtyre trajnimeve, pjesëmarrësit do t'i rinovojnë certifikatat për trajnues për zgjedhje në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve.

4. EDUKIM I ANËTARËVE TË KOMISIONEVE KOMUNALE TË ZGJEDHJEVE DHE TË KOMISIONIT ZGJEDHOR TË QYTETIT TË SHKUPIT

Trajnues: Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, përkatësisht anëtarë të ekipit për edukim i Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve

Gjashtë ekiye të trajnuesve të certifikuar, të formuar prej nga dy anëtarë të ekipit, do t'i mbajnë këto punëtori.

Pjesëmarrës: Anëtarë të komisioneve komunale të zgjedhjeve dhe të komisionit zgjedhor të Qytetit të Shkupit, sekretarë të komisioneve komunale të zgjedhjeve dhe të komisionit zgjedhor të Qytetit të Shkupit dhe zëvendës të tyre

Orari i punëtorive:

30 gusht – 7 shtator

Një ekip në nivel ditor mban vetëm një punëtori.

Gjithsej duhet të zbatohen 40 punëtori me nga 24 pjesëmarrës.

Një punëtori shtesë do të organizohet për KZQSH.

Vendi i mbajtjes:

Për lokacionet e sakta të mbajtjes së punëtorisë, komisionet komunale të zgjedhjeve me kohë do të jenë të informuara. Komisioni komunal i zgjedhjeve në komunën e të cilit do të mbahet punësia do të jetë i angazhuar për të siguruar hapësirë për realizimin e punëtorisë.

Në punëtorinë, detyrimisht duhet të marrin pjesë të gjithë pjesëmarrësit e ftuar.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, anëtarëve të komisioneve komunale të zgjedhjeve dhe të komisionit zgjedhor të Qytetit të Shkupit të cilët marrin pjesë në edukim, do t'u lëshojë vërtetime për pjesëmarrje në edukim.

Në punëtoritë do të përcaktohen temat në vijim:

1. Sistemi zgjedhor dhe zgjedhje për kryetarë të komunave dhe për anëtarë të këshillave të komunave dhe të Qytetit të Shkupit
2. Zgjedhje dhe përbërje e KKZ dhe KZQSH
3. Persona të cilët mund ta monitorojnë punën e KKZ/KZQSH
4. Formim i këshillave zgjedhorë
5. Pranim i listave të kandidatëve
6. Material zgjedhor
7. Pranim i njoftimeve për votim të personave të sëmurë, të pamundur përkatësisht të personave në paraburgim shtëpiak
8. Përmbledhje dhe përcaktim i rezultateve

Sipas nevojës do të organizohen punëtori shtesë për KKZ, përkatësisht KZQSH, ku do të mbahet rreth i dytë i zgjedhjeve.

5. EDUKIM I ANËTARËVE TË KËSHILLAVE ZGJEDHORË

Trajnues: Trajnues të certifikuar të KSHZ-së

Gjashtëdhjetë ekipe me trajnues të certifikuar, të formuara me nga dy anëtarë të ekipit, do t'i zbatojnë këto punëtori.

Pjesëmarrës: Anëtarë të këshillave zgjedhorë dhe zëvendësit e tyre

Orari i punëtorive:

25 shtator – 10 tetor

Gjithsej duhet të zbatohen 1160 punëtori me nga maksimum 30 pjesëmarrës.

Në nivel ditor do të mbahen nga dy punëtori.

Vendi i mbajtjes:


Komisionet komunale të zgjedhjeve do t'i organizojnë punëtoritë për edukimin e anëtarëve të këshillave zgjedhorë në kompetencë të tyre. Datën dhe vendin e saktë të mbajtjes së punëtorive do t'i përcaktojnë komisionet komunale të zgjedhjeve në bashkëpunim me ekipin për edukim me qëllim të planifikimit të tyre.

Prezenca në punëtoritë është obligative.

Ekipi për edukim në bashkëpunim me komisionet komunale të zgjedhjeve, këshillave zgjedhorë që do të marrin pjesë në edukimin e detyrueshëm, do t'u lëshojnë vërtetime për pjesëmarrje.

Në punëtoritë do të përpunohen këto tema:

1. Zgjedhja dhe përbërja e këshillit zgjedhor
2. Aktivitete të KZ një ditë para zgjedhjeve

- 
3. Dita e zgjedhjeve
 4. Përmbledhje dhe vërtetim i rezultateve nga votimi në vendvotim
 5. Paketim i materialit për votim
 6. Restriksione në vendvotim
 7. Bashkëpunim me policinë në ditën e votimit
 8. Ushtrim për plotësim të procesverbalit nr. 16

Sipas nevojës do të organizohen punëtori shtesë për ato KZ të cilat do të realizojnë rreth të dytë të votimit.

6. ON-LINE KURSE

Për shkak të arritjes së qëllimeve të këtij programi, ndërsa duke i pasur parasysh tendencat globale në zbatimin e trajnimeve, në internet faqen e KSHZ-së do të jenë në dispozicion edhe onlajn kurse për edukim të komisioneve komunale të zgjedhjeve, të komisionit zgjedhor të Qytetit të Shkupit dhe të këshillave zgjedhorë.

Secili shfrytëzues i kursit do të duhet gjatë paraqitjes t'i plotësojë fushat për regjistrim. KSHZ do të ketë mundësi të kontrollojë cilët anëtarë të KKZ-ve dhe KZ-ve e kanë vizituar kursin dhe nëse kanë fituar certifikatë për kurs të mbaruar.

Kurset do të përmbajnë pjesë tekstuale me përmbajtje edukative dhe informative, ilustrime me fotografi si dhe test të cilin secili shfrytëzues do të jetë i detyruar ta kalojë.

Pyetjet nga testi do të jenë me më shumë opsione për përgjigje, ndërsa pasi të përgjigjen të gjitha pyetjet, kursi do t'i jep përgjigjet e sakta si dhe më tepër informata rreth përgjigjes.

7. KORNIZË KOHORE E AKTIVITETEVE NGA KY PROGRAM

AKTIVITETI:	Gusht			Shtator				Tetor			
	1-15	16-22	23-31	1-12	13-19	20-26	27-30	1-10	11-17	18-24	25-31
Thirrje për paraqitje të kandidatëve të interesuar për trajnues	☐										
Zgjedhje e trajnuesve		☐									
Njoftim për trajnuesit për kohën dhe vendin e mbajtjes së trajnimit për trajnues			☐								
Trajnim për trajnues të punonjësve në SHP të KSHZ-së			☐								
Trajnim për trajnues 1				☐							
Trajnim për trajnues 2				☐							
Trajnim i avancuar për trajnues 1					☐						
Trajnim i avancuar për trajnues 2					☐						
Përgatitje e materialeve për trajnim		☐	☐	☐	☐	☐					
Punëtori për KKZ			☐	☐							
Punëtori për KZ						☐	☐	☐			
Punëtori për KKZ rrethi i dytë										☐	
Punëtori për KZ rrethi i dytë										☐	

Numër: ____ - ____ / ____
____.____.2021

KOMISIONI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
KRYETAR

Проф. д-р Александар Даштевски